



REPUBLIKA E KOSOVES
 REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVES
 POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA / POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
 Hajvali - Prishtinë



Pr. Nr.	31.07.	Viti: 20	26
Nr. d. d.	Shënim klasifikuese Zna. klasifikuese	Nr. themelor Osnovni Br.	Nr. faqeve Br. lista
01.2	111	112	1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme -Ministarstvo Unutrašnjih Poslova -Ministry of Internal Affairs

Inspektorati Policor i Kosovës/ Policijski Inspektorat Kosova/ Police Inspectorate of Kosovo

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme/ Odeljenje za Finansije i Opšte Usluge/

Department of Finance and General Services

Divizioni i Burimeve Njerëzore/ Divizija Ljudskih Resursa/ Division of Human Resources

Datë: 31/07/2026

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVES
SHPALL
KONKURS

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, për vitin akademik 2026-2027

Inspektorati Policor i Kosovës në vitin e parë të studimeve, për vitin akademik 2026/2027 do të regjistrojë **1 (një) student** në Fakultetin e Sigurisë Publike në AKSP, sipas kuotës së përcaktuar nga Bordi i AKSP në programin studimor bachelor në sigurinë publike.

KUSHTET E KONKURSIT

Kushtet e përgjithshme për aplikim në studimet bachelor për zyrtarët e Institucioneve të Sigurisë Publike janë si në vijim:

1. Të kenë të përfunduar me sukses shkollimin e mesëm të vërtetuar me diplomë;
2. Të jenë të punësuar në Inspektoratin Policor të Kosovës

Kushtet e veçanta për aplikim në studimet bachelor për zyrtarët e Institucioneve të Sigurisë Publike janë si në vijim:

1. Aprovim paraprak nga mbikëqyrësit i drejtpërdrejtë;
2. Punonjësit të cilët kanë kualifikimin e shkollës së mesme si dhe ata të cilët janë të kualifikuar me fakultet por që nuk janë të fushës së sigurisë, administratë, juridik ekonomik.

Kandidatët mund të konkurrojnë vetëm në drejtimin e studimit sipas institucionit punëdhënës.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM:

Formulari i aplikimit i plotësuar dorëzohet së bashku me dokumentet në kopje fizike si vijon :

- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e kartelës identifikuese të punës;
- Dëftesat origjinale të të gjitha klasave të shkollës së mesme dhe diploma origjinale e shkollës së mesme ose kopjet e noterizuara, nëse shkollimi i mesëm është kryer jashtë vendit duhet edhe vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.

Për zyrtarët që përzgjedhin nga Institucionet e Sigurisë Publike për regjistrim në studimet bachelor në FSP lidhet Kontrata mes Institucionit punëdhënës dhe zyrtarit të përzgjedhur në mënyrë që pas përfundimit të studimeve bachelor zyrtari të shërbejë në institucionin punëdhënës -- vite sipas vendimit të përcaktuar nga Bordi i AKSP-së (rikthimi i investimeve),

Dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore- zyra e personelit nr. 102/A&B, nr. 038 200 19 686 .

Studimet bachelor për pjesëtarët e Inspektoratit Policor të Kosovës ofrohen falas dhe pa shkëputje nga puna.

AFATET E KONKURSIT

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë, paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës 03.08.2026 deri më 17.08.2026 në ora 16:00.

MËNYRA E TESTIMIT:

Testi me shkrim do të mbahet në objektin e IPK-së (për datën dhe orën e testimit do të njoftoheni me kohë).

Kandidatët të cilët i nënshtrohen testit me shkrim duhet të kenë me vete një dokument të identifikimit dhe nuk lejohet asnjë pajisje tjetër elektronike.

SHPLLJA E REZULTATEVE:

Shpallja e rezultateve të testimit do të bëhet brenda dy ditë pune në tabelën zyrtare në objektin e IPK-së

ANKESAT:

Kandidatët të cilët nuk pranohen në vitin e parë të studimeve mund të paraqesin ankesë pran Divizionit të Burimeve Njerëzore, pas shpalljes së rezultateve të cilat shqyrtohen brenda dy (2) ditë pune.

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni [të përcaktohet njësia përgjegjëse pran institucionit]. Divizionin e Burimeve Njerëzore- zyra e personelit nr. 102/A&B, nr. 038 200 19 686